



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 2651/2 Prot.

Tiranë, më 13/11/2025

V E N D I M

Nr. 62, datë 13.11.2025

PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT,
MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI KIMIKE, NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma dh, neni 75, në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar, në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" i ndryshuar, në Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike Nr. 28, datë 02.10.2025, dhe në Relacionin e ardhur nga Drejtoria e Kurrikulave, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.11.2025,

VENDOSI:

Miratimin e hapjes së programit të ciklit të dytë të studimit, "Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike", në Departamentin e Inxhinierisë Kimike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo